



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË GJASHTË TË RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 28.06.2016, E martë, në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë, kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu, këshilltaret e Kuvendit, Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Bislim Bislimaj, Sejdi Emini, Baki Nebiu, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Mirlinda Sadiku, Majlinda Ostrogllava, Selvije Rexhepi, Besjana Rexhepi, ndërsa munguan Arbresha Ibrahim, Daut Xhemajli. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrtarja e Zyrës Ligjore, KFOR-i amerikan, përfaqësuesi i OSBE-së, mjetet e shkruara dhe elektronike.

Pasi u konstatua se në sallë prezent janë 25 anëtarë të KK-së, andaj kemi kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Përshëndetje për Nënkryetarin e Komunës, sot jemi te nderuar se prezent kemi edhe KFOR-in amerikan, përshëndetje për të gjithë ju Anëtarë të KK-së, Drejtoret e drejtorive si dhe ju të pranishëm, dhe mirë se keni ardhur ne mbledhjen e VI të rregullt të KK-së.

Kryesuesi i njoftoj te pranishmit se ka marr konfirmim nga Ministria e Pushtetit Lokal, që te gjitha aktet e nxjerra nga seanca e kaluar janë ne përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje lokale, e ku i falënderoj asamblastët për kontributin e dhëne në këtë aspekt.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë para se me kalua te rendi i ditës, ja jap fjalën drejtoreshës së Kulturës, Rinisë dhe Sporti, për një informate te shkurtë.

Drejtoresha znj.Kaltrina Sylejmani: Faleminderit Kryesues, i nderuari Nënkryetar, të nderuar kolege drejtorë, të nderuar asamblastë të Kuvendit komunale, i nderuar KFOR, e ju te pranishëm ne këtë seance! Unë desha te bëje një njoftim, paraprakisht kisha luture sekretarin e Kuvendit t'i shpërndaj ftesat, të cilat sot ju kam sjellë juve. Bëhet fjalë për një aktivitet të

cilin jemi duke e organizuar në bashkëpunim me KFOR-in, bëhet fjale për hai-king, që do të organizojmë me 3 Korrik, për nderë të ditës së Pavarësisë së Amerikës dhe po ashtu si qëllime për ti promovuar bukuritë natyrore të Maleve të Karadaket. Do të ishte nder për ne si organizatorë dhe edhe për trupat e KFOR-it që i kemi në monitorim në Viti, të jeni edhe ju prezent si përfaqësues të legjislativit të komunës tonë. Kjo agjendë do të realizohet me 3 korrik dhe detalet i keni në ftesat e juaja, aty e keni të bashkuar gjithashtu edhe hartat, vendin ku do të shtegtojmë. Në rast se asamblistët nuk i kanë hartat, ata që ju bashkohet aktivitetit do të pajisen atë ditë në mëngjes me hartat ka do të udhëtojmë. Ju faleminderit!

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit për këtë informacion! Po besoj që shumica e asamblistëve do të jeni pjesëmarrës në këtë aktivitet, të organizuar nga ju, së bashku me KFOR-in amerikan. Para se të kalojmë në rend të ditës, e kemi edhe një informacion tjetër. Megjithatë Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e ka mbajtur një takim e ku i ka nxjerr disa rekomandime, unë po e shfrytëzoj rastin ta falënderojë këtë komitet për aktivitetin që e ka bërë, do të ja jap fjalën kryesueses së këtij komiteti, doktorëshës Xhilsime Qamili.

znj. Xhilsime Qamili: Faleminderit kryesues, përshëndetje për Nënkryetarin, përshëndetje për të gjithë ju që jeni prezentë! Unë në pika të shkurta do të beje një informatë në emër të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Në bazë të gjeturave dhe takimeve që kemi pasur me stafin e qendrës së shëndetit mendore në Gjilan, ku në takimin e fundit të mbajtur më 25.05.2015, është arritur një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Komitetit, Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare me Qendrën e Shëndetit Mendore në Gjilan, që pacientet me aftësi të kufizuara mendore dhe pacientet të cilët jetojnë të vetmuar, pa askënd në familje, të qëndrojnë së paku një herë në javë në Qendrën e Shëndetit Mendor në Gjilan. Kjo nënkupton për ata pacient të cilët nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e kësaj qendre dhe transporti i këtyre pacientëve kemi parapa dhe është vendosur që të bëhet nga stafi i Qendrës së Shëndetit Mendore dhe nën përkujdesje e po aty stafi. Kështu që, kjo marrëveshje ka filluar që të implementohet menjëherë pas arritjes së marrëveshjes që e kemi bërë, prandaj edhe ky komitet doli me një rekomandim, që besojmë që është i një rëndësie të veçantë. Po ashtu për komunën tonë të shikohet mundësia financiare, që të mundësohet hapja e një shtëpie të komunitetit në komunën tonë për personat me aftësi të kufizuara mendore, kuptohet personat me retardime të rënda, e cila do të shërbente në masë të madhe në risocializimin e kësaj shtrese të shoqërisë. Modele të kësajllë kemi edhe nga komunat e tjera, kjo për veç risocializimit do të mundësonte ndryshimin e gjendjeve edhe aktualitetin që e kemi në komunën tonë. Ju faleminderit!

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit doktorësh për këtë informatë që na solle! Po shpresoj, që edhe komitetet e tjera të cilët janë formuar në kuadër të Kuvendit Komunal të jenë me aktive, dhe natyrisht të dalin me rekomandime të caktuara. Do të jenë të mirëseardhura. Në seancën e fundit të komitetit, të cilën e kemi mbajtur javën e kaluar, e kemi pasur një kërkesë nga këshilltari komunal, z.Adnan Imeri, në lidhje me disa prona që kanë qenë prona shoqërore, dhe kërkesa e Këshillit të Fshatit Sllatinë ka qenë që ti jepet në shfrytëzim këshillit të fshatit. Natyrisht në jemi konsultuar me Zyrën Ligjore dhe Zyra Ligjore ka përgatitur një dokumentacion në aspektin ligjor, lidhje me këtë, dhe unë ja dorëzoj z.Adnanit këtë shkresë.

Te nderuar këshilltar, kalojmë të pyetjet ose propozimet: A ka dikush prej juve ndonjë pyetje apo propozime.

z.Samet Idrizi: I nderuari Kryesues, Nënkryetar, për te gjithë te tjerët te pranishëm, përshëndetje. Unë e kame një pyetje ne lidhje me tretarin, që është ndërtua vitin e kaluar në drejtim te fsh.Binçë, ajo është quajtur edhe si shëtitore, mirëpo prej rrugës së Beguncës është shkëput, edhe nja 100 metra aty nuk janë shtruar, çka po doket shume keq. Pyetja ime është, pse trotuari qe konsiderohet si shëtitore, mire është punuar pak a shume sa shihet, e qëndrueshmëria do te duket me vonë. Aty është edhe për sy keq, por edhe për me hec shumë keq, kështu që sigurisht përgjigjet nënkryetari për çka aty është shkëput, se shume keq ashtu ku janë pengesat. E dyta, kame një kërkesë prej rrugës "Elmi Demiri", këtu ne Viti, ne qytet te Vitisë, aty janë dikune 35 shtëpi e janë pa kanalizim, edhe kërkesa e imja, edhe si propozim, që me shume duhet komuna me u fukusu ne ndërtimet e kanalizimit se sa ne shtrirje e asfaltit. Ka shume pjesë te Vitisë, po edhe nëpër fshatra, qe ende nuk kane kanalizimet, kanalizimet mbi toke paraqesin edhe rrezik për shëndetin e qytetarëve, kurse rrugët edhe mos me qenë te asfaltume për një kohe nuk paraqesin rrezik. Kërkoj falje, dëshiroj me përshëndet edhe KFOR-im amerikan. Ju faleminderit!

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për te gjithë te pranishmit, po ashtu edhe për KFOR-in Amerikan! Pyetja parë ka te beje me asfaltin e Terpezes, kërkoj nga zyra e mbikëqyrjes se projekteve te na tregon çka ndodhi, çka shkoj keq me këtë asfalte, qe nuk është ne gjendje te rregullt, nuk është ne gjendje të mirë e ku po shkaktohet dëme qytetarëve te Vitisë. Ma merr mendja që Kuvendi është këtu ku thuhet gjerat e ndahen mjete buxhetore. Pyetja tjetër për z.Qahil Sinanin, bursat, studentët po pyesin kur. Pyetja tjetër, nga inspektimi i fundit nga inspektorati ka rezultuar se uji është i kontaminuar ne shumicën e shkollave te Komunës se Vitisë, çka do te ndërmerrni ju si drejtori komunale, qe fëmijët tanë te mos pinë ujë te kontaminuar. Pyetja e fundit për drejtorin e Shëndetësisë: Pse nuk është ripërtëri kontrata me institutin e shëndetit publik?

z.Bislim Bislimi: Përshëndetje për te gjithë! Unë dua ta shpreh një shqetësim timin. Pramë një informacion ne KTV, duhet se ne ambulancën e Vitisë nuk ka pasur mjek, e pashe me filmim. Mua me vjen keq, se unë gjithnjë kam qenë kritik i madhe i këtyre, i kësaj çështje, për tjera çështje jo qe kanë mundu mjeket, por me te vërtet me erdhi shume rende kur e pashe atë film dhe tash kërkoj prej neve ta bëjmë një komision dhe ta shohim se ku është dhe nëse dikush ka dizinformur, unë nuk e besoj qe ambulanta e Vitisë rrinë pa mjek, prandaj unë po dyshoj, ngase qe KTV edhe një herë e ka pas dhënë një kështu, qe kanë qen ne gjumë mjeket. Të formohet një komision, të shikohet se a është e vërtet a po jo, e nëse kjo ka ndodh, nëse është e vërtet, atëherë duhet dikush te përgjigjet.

z.Bekim Azizi: Faleminderit, përshëndetje Kryesues, Nënkryetar, Anëtarë të Kuvendit, përfaqësues te KFOR-it e pjesëmarrës te tjerë! Un ne seancën e kaluar kërkoja një liste te rrugëve rurale, qe janë duke u shtruar me asfalt, por nuk i pasni pruar, besoj qe ne seancën tjetër i bini. Dy çështje qe do ti ngris sot, ne këtë kohe te fundit kemi pas bajagi shume pjesëmarrje te Varrezat e Dëshmorëve, një pjesë e pllakave te varrezave shihen qe janë shkatërruar plotësisht, unë mendoj qe aty duhet te merret një hap urgjentë, të behet një meremetim sa do qe nuk do një shumë te madhe te mjeteve, por për një meremetim te pllakave qe ishin dëmtuar te varrezat e dëshmoreve, unë mendoj qe duhet një përkushtim dhe

ajo shpejt mund të kryhet. Edhe çështja dytë, një pyetje, ne Drobesh, te pjesa ku mendohet e behet edhe palestra sportive, ne dy anët e rrugëve është bërë një deponi e mbeturinave te ngurta, nuk e di aty a behet me leje a po qyshe, çdo kamjan, çdo mbeturinë e ngurtë aty shkarkohet, ne dy anët e rrugëve. Unë nuk e di pse mundet mu bë aty ku është ne rruge magjistrale, a kanë drejt me bë aty atë deponi ose a kanë drejt mu hedh ato mbeturina te ngurta ne at pjesë te rrugës.

z.Baki Nebiu: Faleminderit kryesues, përshëndetje për KFOR-in e për te gjithë te pranishmit! Unë e pyes Zyrën e Projekteve ose drejtorin e Inspeksionit, rruga "Rexhep Bislimi" këtu ne Viti, më konkretisht para stacionit te autobuzave, me sa e di unë kjo rruge është shtruar vjet, kurse para nja një jave ose dy i pash tu e riparua, tu e pre asfaltin. Du me ditë ku po qëndron problemi, pse asfalti është prish brenda një viti, pse janë bë këto prerje. Pyetja tjetër është, mbeturinat e Komunës se Vitisë, unë e di qe këto i mirëmban një kompani private, por kjo kompani me sa o duket është problem me mirëmbajt tanë territorin e Komunës se Vitisë. Unë ju kisha lut si komunë, qe ju te bëni kërkesa te vazhdueshme ndaj kësaj kompanie, qe me përfshi te gjithë territorin e Komunës se Vitisë. E keni bërë një pune shume te mirë atje te "Morava", po ne qoftë se nuk e rritni territorin për mbledhjen e mbeturinave, shume shpejt keni me pa "Moravën" te mbushur me bërlllogje. Pyetja tjetër për palestrën sportive, gati u krye mandati dhe hala nuk i pashe gurthemet tu ja fillu. Du me ditë, pyetje konkrete: Se kur ka me filluar kjo palestër sportive?

Kryesuesi: Pasi qe nuk ka pyetje te tjera, fjalën ja kalojmë nënkryetarit.

Nënkryetarit z.Hasan Alia: Fillimisht me lejoni ta përshëndes Kryesuesin, Këshilltaret e Kuvendit Komonale, drejtoret e drejtorive, zyrat përcjellëse te kryetarit, KFOR-in amerikan, i cili është prezent sot këtu, përfaqësues te OSBE-se dhe ju te pranishëm te tjerë! Unë do te beje përpjekje te ju përgjigjem te gjitha atyre pyetjeve, për te cilat jam ne rrjedh e jam ne kompetencën e kabinetit te kryetarit dhe do ti la disa te tjera për te cilët i kem drejtorët e drejtorive këtu, qe janë më ne rrjedha dhe do t'i merrni përgjigjet prej tyre.

Pyetja e parë ishte trotuari ne rrugën e Binçes, do te vazhdon faza tash a e quajmë e tretë a po e dytë, dhe do ta vazhdojmë edhe atë pjese dhe do ta lidhemi deri te shkolla e mesme teknike apo deri te rruga e Begunces. Për kurrfarë arsye nuk është ndal, por është ndal për arsye te mungesës se mjeteve, deri aty ka pas dhe do te vazhdojmë. Çështja e kanalizimit, është e vërtete, se ne jo vetëm ne rrugën "Ilmi Demiri", por kemi edhe pjesë te tjera, te cilat nuk kemi mujtë me i mrri nga buxheti te cilin e kem, prandaj se shpejti do ta kemi edhe shpalljen e tenderit. Tash a do te jetë kjo rruge nuk e di, vetëm me gjithatë janë shume rrugë edhe te Vitisë e te lokaliteteve te ndryshme dhe do te jetë një tender i përbashkët qe do bejmë përpjekje maksimale qe të eliminojmë ose t'i plotësojmë ato lagje, qe me te vërtet nuk kanë kanalizime. Çështja e asfaltimit te Terpezes, unë nuk e di pse e bene pyetje, thu t'i marr nga projektuesit. Ne e dimë si problem sikur ju, edhe mete vërtet ajo është shqetësuese, megjithatë ne ju kemi thënë edhe ne seancën e kalume, se ne kemi bërë një trusni ne kompani, se shihet një seriozitet aty nga vete Qeveria Komonale, për shkak se ka arrit dhe po i mënjanon te gjitha ato defekte te cilët kërkushe nuk i ka kontestua qe i ka pas kjo. Është shume pozitive, ndoshta edhe një fitim te garancionit prej tashti edhe një vit qe do ta ket

rruga e Terpezes, këto janë ato forma ligjore dhe format e mundshme që mund të behet një kompanie, kur qeveria udhëheq me duart të pastërta dhe e kthen kompaninë me përmirësu atë të cilën e ka bërë me gabime apo nuk e ka bërë kualitetin me të lartë të mundshëm, me evituar, prandaj unë nuk di përgjigjen me të mirë dhe me të saktë e mëtej vërtet se kjo, mirëpo nëse ti je e interesum, unë ti sjelli shkresat, që ne ju kemi dërgua kompanisë e ku kemi marr garancion që do të eliminohet kjo gjendje e ku do të fitojmë garancion edhe për një vit, ngase që ti e din, që projekti kapital garancion ka një vit, që tash e kemi shtu edhe një vit, d.m.th prej moment të mënjanim të të gjitha defekteve, që është ka punohet atje, që është në përfundim, do të marr edhe një vit garancion për atë rrugë, e ku konsideroj që është një hap i mirë, është një qeverisja me duar të pastërta. Krejt këto do të bëhen me qato mjete që janë paraparë në kontratë, pa mjete tjera shtese. Te uji i kontaminuar, në që kemi në qeveri, kemi arrit me e nënshkrua një kontratë, që të rregullohet uji në të gjitha shkollat, ato të cilat e kanë konstatuar, që është i kontaminuar, ndërsa gjashtë vjet përpara ke pirë ujë të kontaminuar dhe kurrë nuk e ke ditë, është mirë me e than edhe këtë të mirë, dhe në momentin e konstatime që kemi të bëjmë me ujë të kontaminuar, në veç e kemi zgjedhe problemin dhe duhet të ndërmarrim masat, të cilat janë adekuate që uji të jetë i pijshëm apo mos të jetë i pijshëm dhe të orientohem diku tjetër, që të shërben vetëm për mirëmbajtjen e pastërtisë në objektet shkollore tona. Në rastë që është e vërtet ajo që e tha Bislimi, ajo është shqetësuese, unë nuk po muj me marr me mënde, edhe pse unë mendoj që shërbimi është në nivelin me të mirë të mundshme, megjithatë mbetet si rast. Unë do ta shikoj se bashku me personelin udhëheqës të QKMFS-së dhe në rast se kjo është e vërtet duhet me shiku se kush ka qen në ndërrim dhe me ndërmarr masa, se plotësisht pajtohem se nuk guxojmë në asnjë moment me qenë pa mjek kujdestare aty. Bekim është me vonës ose gabimi im, e kame dhanë dje përgatitjen e listës, e marr me sinqeritet përgjegjësinë për ato, ngase që nuk e kisha pas të shënuar që të përgatitet për këtë seancë, në seancën e ardhshme do ta merreshe pa problem. E kemi parë na, që ka fillua mu shkatërrua, ramja e pllakave ka qen shumë shqetësuese, pajtoheshe edhe ti si unë se e ka bërë një qeveri lirisht mundem me than e papërgjegjëse, se brenda katër pesë vite me ra ato është shumë keq, ngase që nëse afateshmeria është aq e shkurte, megjithatë unë nuk e kam ndërmend mu marr me ato të kalimet, por në e kemi marr iniciativën, Kryetari e ka thirr një ditë kryetarin e shoqatës, shoqatave të ndalura nga lufta, familjen e dëshmorëve, edhe veteranet kanë dal e kanë vozitë, po bëjmë përpjekje që të eliminohet, se në qatë formë në s'mund t'i lëmë. Baki aty ku pyet ti, është fjala për rrugën magjistrale, d.m.th e cila është kryer vitin e kaluar, edhe unë sot e kam pa që është bërë prerja vende vende, me siguri është dëmtua, e ka garancion një vjeçar, prandaj aty ku është plasarite edhe e bëjnë evidimit. Mbikëqyrjen e ka bërë ministria, parët i ka dhënë ministria, megjithatë edhe eliminimin e bëjnë. Ndërsa të mirëmbajtja e bërllokut, nuk është kompani private, por kompania "EKO Higjiena" kujdeset për mirëmbajtje e Komunës së Vitisë, një kompani publike private. Unë e di që kemi nevojë edhe me shumë për mi mbuluar nevojat tona, edhe në rritjen e kapaciteteve të stafit edhe rritjen e mekanizmit që duhet të veprojnë, në të gjithë duhet të kemi në ngritje të vaditjes qytetare, me shumë për mirëmbajtjen e hapësirave tona, nuk e them këtë rastësisht, atje ka fillua të behet një shëtitore e mirë, me dru dekorativ përcjellëse,

qe do te behet me te vërtete një dobi, të i leme diçka brezave të ardhshëm dhe domi të mendojmë. Ajo është e mirë, por ne këtë formë, unë konsideroj qe duhet te flasim edhe aty ku e kemi ndikimin, edhe ne familje edhe ne rrethe, edhe ne fshatë, edhe ne lokalitet, që më të vërtete hedhja e mbeturinave ne ato pjesë sjell dëme, edhe është krim në natyre qe e bënë, është një lloj krimi. Prandaj, unë konsideroj qe ne mundemi me ndikuar dhe ta ngritmi vetëdijen për mirëmbajtjen e hapësirave tona te rregulluara edhe ato te cilat janë te parregulluara, por qe janë pa mbeturina. Te çështja e palestrës sportive, ju e dini qe kur te vareshe nga qendra, qe investon, atje po ka problem, e shpallin tenderin e anulojnë, megjithatë kërkesa e fundit e kryetarit, ai ka kërkuar qe ato mjete te barten ne komune dhe komuna ti udhëheq procedurat, me siguri do ta kishim udhëheq shume me mirë e me shpejt, e tash do te kish fillua palestra sportive, por megjithatë këto nuk po varen krejt prej neve, po varen nga ai i cili I ka mjetet. Kërkesa e kryetarit ka qen kjo, se edhe neve na ka lodhe me ato shpallje tenderash, anulim tenderëve, se ajo është edhe humbje kohe edhe shpenzim, por kjo është gjendja e cila është, datë të sakte për fillim nuk mundem me te dhëne, se nuk ka datë. Ju faleminderit!

Drejtori z.Qail Sinani: Përshëndetje për te gjithë! U parashtruan dy pyetje shume me rendësi. Çështja e bursave, është viti kalendarik ne arsim shtator-shtator. Vitin e kaluar I kemi dhënë me herët, keni thënë qe kemi jap për pushim verore. Kështu që ka kohë prej nga shtatori ne shtatorin tjetër, prandaj nuk është qit anash bursa, vetëm qe janë prit edhe nga kryetari, qe te ndan një pjesë te mjeteve për to, por nuk është me vonës qyshe e keni marre. Sa I përket ujit të kontaminuar, e tha edhe nënkryetari, nuk ka qenë bashe qashtu qyshe e kane bërë shume te madhe, ngase asnjë ujë I shkollave nuk është I veçanet, por është ujë I kyçur, fshatrat qe e kane ujësjellësin prej fshatrave, e nëse është I kontaminuar ne shkolle, atëherë është I kontaminuar edhe ne katund, por a duhet kujdesemi për to, po patjetër kemi, marr angazhim, qe ka fundi i muajit gusht te behet kontrollimi I të gjitha shkollave me ujë te pijes, dhe te shihet se a është ne përdorim a po jo. Ju faleminderit!

Drejtori z.Basri Aliu: Përshëndetje për te gjithë, faleminderit për pyetjen e bërë! Në lidhje me marrëveshjen me shëndetin publik, qe e kemi, pasi deri tani ka qenë ajo, marrëveshje tash ka skaduar, kontrata, jemi ne proces e sipër për fillimin e marrëveshjes se re, ndërsa sa I parkete rreth rasti qe ke për mungesë te mjekut nuk kisha çka me shtuar me tepër vetëm ata qe e tha nënkryetari, do te shohim se ku qëndron çështja. Ju faleminderit!

Drejtori z.Skender Ahmeti: Përshëndetje për te gjithë te pranishmit! Unë dola që ta bëjë një njoftim publik edhe për juve, edhe për te gjithë qytetaret, ngase ndoshta e ndjekin drejtpërdrejt transmetimin e seancës. Sot kame marr një vendim nga Agjensioni I Veterinës dhe Ushqimit te Kosovës, qe te ndalojmë me qarkullimin e kafshëve brenda territorit te Kosovës, ne këtë rast edhe territorit te Vitisë, përshkak se është paraqit një s'mundje e lëkurës se gurgur te gjedhi, qe ishte e pranishme pak me herët ne shtetet fqinje, si Maqedonia dhe Serbia. Kështu që dola me shume qe ti njoftoj qytetaret, se te Enjten nuk do te mbahet tregu i kalesheve. Është me keqardhje, qe duhet ta them këtë, për shkak se po me përsëritet për herë te dyte gjate mandatit, qe e kame ndërpre edhe para dy viteve kur ka qen koha e Kurban Bajramit edhe tash, qe po me duhet me përdorë këtë ndalesë, kështu që kërkoj një

mirëkuptim nga qytetaret. Ne do ti marrim masat si inspektorat, ne bashkëpunim me policinë, ngase edhe ajo është e njoftuar për këtë masë, dhe ne te gjitha rastet kur haset, qe kafsha është e sëmurë, ne do ta marrim, do ta asgjësojmë dhe do ta varrosim ne vendvarrezat qe i kemi përkatëse. Për fatë ne Kamenicë është paraqit një rast I tillë, edhe një ne Mugillë, edhe pse Komuna e Vitisë është e pasur, por Mugilla është këtu afër, kështu qe kërkoj mirëkuptim nga qytetaret, se te Enjten nuk do te mbahet tregu i kafshëve dhe nuk lejohet qarkullimi i kafshëve, as prej fermave ne ferme. Janë te parapame edhe disa masa te tjera dezinfektuese nga Agjensioni, për raste te asgjësimit sigurisht do te kompenson. Ju faleminderit!

znj.Mirlinda Sadiku: Nënkryetar, asnjëherë nuk e kam drejtua gishtin me than, qeveri me duar te ndotura, mirëpo me vonë ju vete e demantuar dhe thate për ato pllakat te varrezat e dëshmorëve, qeveri e papërgjegjshme, atëherë si do te ja ngjasim emrin asfaltit te Terezës. Të lutem, te investohet 200 mije euro vlerë edhe ata njerëz d.m.th te kenë vështirësi ne qarkullim, është personi qe ju ka bërë dëm, d.m.th prapë qe te arsyetohet një vit tjetër garancion, kjo është shume pake. Unë kam thënë, nëse ka mundësi, nëse ka nevojë, ky Kuvend mund t'i ndaj mjete shtese, nëse ka nevojë për pune ekstra shtese. Ndërsa sa i parkete ujit te kontaminuar, unë e di "retër klub interneshell" ka investua ne pompa edhe ne filtrimin e ujit, mirëpo informata te sigurta janë nga inspektorat, te cilët kane thane, qe uji ka dal me përmbajtje bakteriologjike, sepse ata filtrat kurrë nuk janë ndërrua ma, ndërsa sa i parkete kontratës, kontrata ka skaduan në dhjetor te 2015.

Nenkryetari z.Hasan Alia: Qeveri me duart të pastra është ajo qeveri e cila ka lidhe kontrate, e kryen projektin, e shtinë kompanin ta përmirëson dhe ta bëjnë ne formën dhe mënyrën qe e ka parapamë ne kontratë, jo me nda Kuvendi mjete shtese, se ky Kuvend ka nda njëherë në kuadër te çati projekti te cilit I keni nda ju mjete, e ka krye nuk I ka dal kualitet edhe është ka e përmirëson. Dhe çështja e garancionit, unë nuk mundë e ndryshoj Ligjin, po te isha ne Parlament te Kosovës do ta kisha bere dhjet vjet, nuk u kane problem, por ligji thatë me se shumti një vit dhe krejt qe kemi arrit, d.m.th, kjo periudha qe ka kaluar një vjeçare, me defekte te asfaltit, e kemi eliminua dhe e kemi fitua një garancion një vjet prej momentit te eliminimit.

Drejtori z.Basri Aliu: Sa për sqarim, se kontrata nuk ka përfunduar ashtu siç tha Mirlinda ne Dhjetor, ngase qe kontrata ka qen deri nga muaji i tret i këtij viti.

Kryesuesi z.Naim Pira: I falënderoj te gjithë parafolësit për kontributin e dhënë dhe deklaroj që në seancën e VI të kemi paraparë këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
- 2. Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e Komunës së Vitisë 2017-2019.**
- 3. Propozim rregullore për plotësim dhe ndryshimin e rregullores mbi Transparencën Nr.01-013/592.**
- 4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme të Komunës Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti.**

5. Propozim vendim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës Kompanisë KKDFE SH.A. "KEDS" J.S.C. për vendosjen e një trafo elektrike.
6. Informatë për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve në Komunën e Vitisë.
7. Informatë për Manifestimin "Flakadani i Karadakut", edicioni XV.

A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutem? Pasi që nuk ka, hedhet në votim për miratimin e rendit të ditës: Kush është për miratim? Konstatohet që me votat e të gjithëve u miratua ky rend dite.

Pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendit Komunal të Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

z.Sami Demelezi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, unë deshta të përmirësoj në procesverbal një fjalë, një fjali, e cila po tingëllon keq, ku është e shkrume, mos i traumatizo, ku duhet të jete mos i dramatizo. Ju faleminderit!

z.Samet Idrizi: Te çështja e lokacionit të zjarrefiksive, ndoshta nuk është dëgjuar mirë, unë kame thënë, terreni po me duket pake i përkthyer e jo i përkthyer.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë, unë po e hodhi në votim: Kush është që të miratohet procesverbali i mbledhja së pestë me qeto ndryshime. Konstatohet se nga të gjithë asamblistët prezent pika e parë e rendit të ditës u miratuar.

Pika e dytë

2. Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e Komunës së Vitisë 2017-2019.

Kryesuesi z Naim Pira: Ftoj drejtorin që ta merr fjalën rrethe kornizës afatmesme buxhetore.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju të nderuar asamblistë, përfaqësues të KFOR-it e ju të tjerë që jeni prezent. Pra, para juve të nderuar asamblist, e keni marr materialin sigurisht me kohë për Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e Komunës së Vitisë 2017-2019, pra jemi në fazën e përgatitjes së draft buxhetit përfundimtar për vitin 2017 dhe projeksionet për vitin 2018-2019, dhe ky është një ndër proceset me të ndërlikuar dhe më intereson për qytetaret e Vitisë dhe për juve këshilltar komunale dhe institucioneve të tjera të Komunës së Vitisë, pra në qarkoren e parë buxhetore për fillimin e procesit, për fillimin e draft buxhetit përfundimtar e kemi marr diku më 24.05.2016, dhe për sqarim ky është një proces që ne duhet mi zhvillu të gjitha hapat, tu e fillua prej Bordit të Drejtorëve, në Komitetin për Politikë dhe Financa, në Kuvendin Komunal dhe duke vazhduare me të gjitha proceset tjera që janë pjesë, që e kompletojnë këtë proces, me qen transparent dhe legjitim për Kuvendin Komunal dhe për organet e saja legjitime, pra, buxheti i komunës së Vitisë si çdo buxhet tjetër, është një ligj, në baze të se cilit organet e Komunës së Vitisë duhet të sillen dhe duhet ta zbatojnë striktë, ashtu qyshe e miraton Kuvendi Komunal, pra një proces kompleks, që na jemi, d.m.th në fazën e fillimit, se bashku me juve dhe të gjithë akterët e tjerë, të cilët janë përgjegjës për përpilimin e këtij drafti. Dhe për të gjithë qytetaret e Komunës së Vitisë duhet me qen një transparencë e plotë, një ndershmëri e plotë dhe konform të gjitha ligjeve që janë pozitive, që funksionojnë në Republikën e Kosovës, tu e filluar nga Ligji për Menaxhimin e Financat Publike dhe Përgjegjësi dhe të gjitha aktet e tjera ligjore.

Konformë të gjitha këtyre rregullave, ne jemi në proces të përgatitjes së kësaj kornize afatmesme buxhetore, dhe që për momentin, në bazë të kësaj kornize buxhetore, ne duhet ta funksionalizojmë buxhetin e Komunës së Vitisë për vitin 2017 dhe projeksionet për vitin 2018-2019. Korniza e parë në bazë të cilës janë nda kufijtë për vitin 2017, buxheti i komunës së Vitisë është paraparë të jete 10 milion e 19 mijë e 208 euro. Në bazë të kësaj shume nominale për këtë buxhet, unë i kame analizua kriteret, në bazë të cilave është bërë shpërndarja e buxheteve komunale dhe kam ardhur në konkludime, se shpërndarja e fondit të nivelit qendror për komuna është bërë mirë, d.m.th janë zbatuar të gjitha ato kritere që janë paraparë, jo vetëm për Komune të Vitisë, por për të gjitha komunat e tjera. Pra, krahasuar me buxhetin e vitit 2016, kemi një rritje prej 6.55%. Në vitin 2016 kemi pas një buxhet prej 9 milion e 487 mijë e 984 euro, kurse në vitin 2017, pra, buxheti është 10 milion e 19 mijë e 208 euro, pra është një buxhet që në mënyrë reale, kur i kame krahasua të gjitha parametrat apo kategoritë ekonomike që kanë qenë të inkomperuar në buxhetin e vitit 2016, kemi një shtim të buxhetit dikur real 142 mijë euro, në bazë të asaj që po ndodhe në vitin 2016 dhe asaj të vitit 2017, gjithë një duke u bazuar që këtë rritje jemi mundu me shpërnda. Pra, kjo është një proces që nuk është vendim marreje definitive. Ne, të gjitha ato vlerësime, vërejtjet, kritikën, propozimet do t'i inkorporojmë gjatë përgatitjes së këtij drafti, pra, nuk është definitive, kjo është një qarkore e parë, nuk duhet të na alarmoj për një të keqe, por që duhet të jem në transparencë të plote dhe në thithjen e informacioneve të dorës së parë, që në kur të përgatitmi draftin e fundit me qenë konform asaj që e kemi, që një ka leju Ministria e Financave, gjegjësisht Qeveria e Kosovës, për këtë buxhet, në dispozicion, në vlerë prej 10 milion e 19 mijë e 208 euro. Si buxhet edhe në KPF kemi marr disa vërejtje nga anëtarët e këtij komiteti, edhe në Bordin e Drejtorëve, nuk jemi të kënaqur maksimalisht, ngase që nevojat e Komunës së Vitisë për intervenime të ndryshme, duke filluar nga investimet kapitale deri të shërbimet e mallrat janë shume të mëdhaja, ja që për momentin ndarja e buxhetit për Komunën e Vitisë. Është kjo, pra, vlera e cekur me lartë dhe këtë buxhet na duhet ta drejtojmë në të gjitha ato kategoritë ekonomike, që kanë nevojë me se shumti dhe aty ku preket me shumë dora e qytetarit, ne do të mundohemi, që shpërndarjen e këtij buxheti ta bëjmë ashtu qyshe është me se miri, gjithnjë duke marrë për bazë edhe mendimet e juaja të nderuar asamblist. Për mos me ju marr kohë me shume, materialin e keni pranuar me kohe, për pyetje e sqarime jam i gatshëm.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapë diskutime rrethë kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Vjollca Kadolli-Halili: Përshëndetje për të gjithë, Kryesues, Nënkryetarë e ju të pranishmit. Për sot kemi Kornizën afatmesme buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2017-2019, në të cilin dokument janë paraqitur planifikimet për buxhetin, në të gjitha kategoritë ekonomike, por janë paraqitur edhe prioritetet e qeverisë për këtë vit, të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në përmasimin e jetës së qytetarëve në të gjitha sferat. Edhe pse ky dokument paraqet qarkoren e parë buxhetore, ashtu siç tha edhe drejtori, megjithatë më duhet inkurajua, duke llogaritur me vitin e kaluar, pasi që shihet që kemi një rritje në të gjitha kategoritë ekonomike, si të grandet e përgjithshme, ashtu edhe të grandit të Arsimit dhe Shëndetësisë, rritje kemi edhe të të hyrat vetanake, gjithashtu inkurajues për një zhvillim ekonomik të Vitisë është edhe tabela e donacioneve nga brenda dhe jashtë, ku vetëm këtë vit ka pasur një shume të konsiderueshme të donacioneve, mbi 1 milion euro dhe presim edhe në të ardhmen, që Qeveria komunale të jete më këmbëngulëse edhe të sjell sa me shume donacione në Viti. Ju faleminderit!

znj. Mirlinda Sadiku: E di që është versioni i parë, leximi i parë, megjithatë kemi disa pyetje. Edhe në KPF pyeta, sipas ministrit Imet Rrahmani, prej në Korrik do të fillojnë sigurimet

shëndetësore, ashtu ka deklaruar, tash sa qëndron kjo unë nuk e di, a do të ketë implikime të buxhetit komunal sigurimi shëndetësore, pastaj kemi teke sa e thatë, e ceket, se vlera ka qenë e asaj tepricës, diku rreth 142 mijë euro, nëse nuk gaboj e ceket që 30 mijë euro do të ndahet për subvencione me intereson, cila drejtori do të përfitonte prej këtij 30 mijë euro subvencione, po ashtu të projeksioni dhe planifikimi i mbledhjes së taksave. Këtu nëse i bëhet një analizë kësaj, shihet, p.sh.: të Drejtoria Komunale e Arsimit 14 mijë e 700 euro duhet, tash nuk e di drejtori sa e ka analizuar gjendjen, mirëpo që dy vite nuk kemi të interesuar për mësim jo formal, kemi dikur rreth vetëm 3 parë dokumenta, pra, pa qenë numri 15 vetë, d.m.th edhe kjo shifër është kontestuese, se çdo të mund t'i gjenerojmë këto të ardhura për në Drejtorinë Komunale të Arsimit apo jo. Më gëzon fakti, të objektivat e arsimit është rritja e përfshirjes së fëmijëve parashkollore, parashihet investime nëpër shkolla aty ku ka parashkollor është një lajme i mirë, mirëpo jam skeptik tu e pa, se investimet kapitale që kanë të bëjnë me shkolla janë të parapara vetëm 70 mijë euro, pastaj kemi përmirësimi i mësimdhënies do të gëzohem shumë edhe unë edhe koleget që janë në arsim, përmirësimi i mësimdhënies, ne qofte se do të na jepni mjete përcjellëse konkretizuese, projektme që mësimi të jete me efektiv edhe me frytdhënës, pastaj e fundit ka qenë forcimi i mekanizmit llogaridhënës. Unë e di që inspektorat janë në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Nuk e di sa mundem me ndiku këtu komuna, megjithatë këto janë objektiva mjaft premtuese, mirëpo kur shikohet shifrat, jam prapë skeptik. Pastaj kemi disproporcion të inspektimi i tokës dhe aktivitetet gjeodezike, ku në vitin 2016 janë të parapara 26 mijë e 500 euro, kurse në vitin 2017 është 85 mijë e 200 euro, 59 mijë euro me shumë. Prapë jam skeptike që munden me e realizua kjo drejtori përkatëse, këto të hyre buxhetore. Të hyrat nga parkingu publik nuk ka, nuk është paraparë, pastaj rritja parashihet të Zyra e Kryetarit shume e subvencioneve edhe trendi është në rritje, ku për vitin 2017 parashihet 126 mijë e 712 euro, kurse për vitin 2018 është 146 mijë euro. Trendi është në rritje vazhdimisht, mirëpo kur po vjen puna për ndarjen e bursave tek studentët, nëse i shikoni projeksionet për 4 vitet e ardhshme 40 mijë euro, është njëjtë, d.m.th nuk po ndikon kjo, megjithatë për vitin 2017 arsyetohet se është vite elektorale ju vyen. Po ashtu është koincidente, p.sh.: më gjithë respektin që ka punuar znj.Kaltrina, e p.sh.: kemi të Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sport, 38 mijë euro, ndërsa për Bujqësi 33 mijë euro, e ku 33% e popullsisë merret me bujqësi dhe gjenerojnë të hyra për familjet e tyre. Pse komuna mos ta ketë një liste të investimeve kapital. Më rastisi të lexojë Kohën Ditore, Komuna e Skenderajt i ka të përgatitura 53 projekte të parapame për tri vitet e ardhshme. Pse edhe Vitia mos ta ketë, p.sh.: tash e kemi, edhe Bekimi që po i kërkon rrugët, na po e dimë cilat rrugë po shtrohet vetëm kur po behet foto lajme.

z.Samet Indriz: Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e Komunës së Vitisë 2017-2019, këtu tek faqja 9, ka qenë dashur pakëz me qenë tabela me e madhe dhe me vizuale, se problem me pa, por herëve tjera behet pak me e madhe për sy. Kur e ban një analizë rreth rritjes së zhvillimit apo buxhetit ekonomik, nëse mujmë me quajte kështu, nëpër komuna edhe e krahasonte buxhetin e vitit 2014 me 2018, është një rrije shume e letë, për 5 vite është një projeksion shume i ulte i buxhetit, që as për afërsisht nuk i plotëson nevojat e qytetarëve të Vitisë. Muj me than që është një rritje ku janë nxjerr mesataren, diku 1.6%, me e ulte se rritja e përgjithshme në nivel të Kosovës dhe buxhetit qendror. Këtë mundëni me krahasuar, vetëm merrne buxhetin e 2014-ës me këtë të 2019-ës. Unë mendoj që prioritet shume të theksuar kësaj kornize buxhetore, duhet me i dhanë ndërtimit të kanalizimeve në nivel vendi. Këtu në Viti shume ka probleme me kanalizim në fshatra, në lagje, në para lagja të Vitisë. Në faqe 12, marrja me qira e objekteve komunale për një afat të gjatë, nuk e di këtu a është nënkuptuar, d.m.th objektet e komunës me u leshu me qira, është një rritje shume e vogël për

vitet e ardhshme. Unë mendoj se ka pas vend me pas inkasim me te mirë, ashtu që edhe këto objekte me qira qe janë dhanë të komunës janë me probleme dhe nuk po mundet me inkasuar te hyra. Nuk e di, vazhdimisht ka pas probleme edhe me herët, edhe tash qe është mirë Komuna këtu me qenë pak me vigjilente, ngase qe ato ne fund te fundit janë lokale te komunës. Lejet e automjeteve për auto-taxi nuk ka rritje hiq, ka fjalë qe shume auto-taxi operojnë pa licenca. Mu me vjen keq, e di gjendjen sociale te rende te qytetarëve, këtu ne Viti edhe ne Kosovë, por megjithatë ai qe punon duhet diçka me pagua, se është me mirë te pajiset me dokumente për naj aksident. Në faqe 13, cerdhet, këtu përkundrazi ka rënie te inkasimit prej 25 mije ne 21 mije, është fute qe ka mu bë edhe një cerdhe e re edhe duhet mu bë edhe një ne Viti edhe ne Pozharan, edhe këtu realisht u kane dashtë mu dyfishuar te hyrat. Faqe 14, e kame një pyetje, sigurish përgjigjet drejtori ose nënkryetari. Ne vitin 2016, Ministria e Infrastrukturës, te hyrat nga donatoret e jashtëm dhe te brendshëm për vitin 2014-2016, 497 mije euro për 2016. Nëse nuk jam mirë i informuar për qete vlerë, ku ka mu investuar kjo, çka parashihet. Faqe 20, unë mendoj qe subvencionet e transferet janë koncentruar bukur shume te kryetari, nuk e di konform ligjit qysh mundet me u be kjo, ndoshta është përqindje qe e lejon këtë kuotë, nuk jam i informuar, sigurisht drejtori Financiar do te na informon. Propozimi imi është qe subvencionet te koncentrohen me shumë ne Drejtorinë e Bujqësisë dhe te Kulturës, megjithatë, nëse kryetarit ja lejon ligji me kuotë, tashti këtu nuk muaj me kontestuar unë. Ky trend i subvencioneve ne Zyrën e Kryetarit vazhdon edhe ne vitin 2017, 2018, 2019, edhe kame vërejt se Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndoshta apet pak janë atemue, unë prej krejt drejtorëve, sinqerisht e kisha veque Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Unë kam pas me këtë një punë, qe është përgjigj shume mirë. Pas kërkesave dha sugjerimeve qe ja ka bere lagjja jem, është rregulluar një projekt aty shume mire edhe propozimi ime është qe te ndahet mjete me shume ne Drejtorinë për Shërbime Publike. Ju faleminderit!

z.Bislim Bislimi: Unë do ta filloja këtë diskutim me këtë hyrjen këtu, ku kem bere për zhvillim ekonomik, edhe ato metodat apo rrugët se si do te behet zhvillimi ekonomike ne Komune e Vitisë apo perspektiven e zhvillimit ekonomik ne viti. Këtu qysh e kemi shkrua ne nja dy tri fjali ndoshta edhe nuk i lexojmë, do ti komentoj dhe do te vijmë ne përfundim, se kjo me te vërtet është hipokritizi e vërtet, sepse ne këtë mënyrë nuk munde te ndodhe qe te zhvillohet një komune vetëm duket qe ne kemi toke bujqësore te mire, ne kemi kushte te mira, kemi kultivues te mire bujqësorë, por ne fakt nëse ata nuk ndihmohen mu ma merr mendja qe nuk kem se çka bisedojmë për zhvillim ekonomike e qe do ta bazojmë kryesisht ne bujqësi, si po thuhet këtu ose ne tregti dhe zejтари. Këtu nderte tjerat, te zhvillimi ekonomik, aty te shtohet, kjo është edhe arsyeja se sektori i bujqësisë është njeri nder sektorët kryesor te zhvillimit te ekonomisë ne Komunën e Vitisë, edhe pse viteve te pasluftës ka mbetu mbrapa ne këtë drejtim etj etj, edhe thotë se i jepet malësia e tregtisë dhe zejtarisë, tash për me drejtuar ata, se nime është hipokritizi. Ne po kërkojmë nga zejtaria dhe tregtia te marrim lek, sepse bujqësia nuk ju mundësohet shitja e produkteve, edhe kjo faktikisht ti nuk mundesh mi marre patatet ose domatet atyre ne vend te shitjes, kur nuk ka shitje nuk mundesh me marr tatime, nuk mundesh mu zhvilluar, edhe kështu bujku e le atë prodhimtari. Rritja e kapaciteteve te fermave, si munde ta rritmi tash, kur ti marrim ti analizojmë këtë si munde ti bëjmë këto kur nuk kemi mjete, kur nuk ndahen mjete. Që katër vite kjo qeveri nuk ka ndarë asgjë për fermer, ne e kemi pas rastin e ngordhjes se deleve atje ne Debelldeh, as një cent nuk ju është dhënë, 200 dele njërit ju kane myt, asnjë kokërr ndimë nuk i kemi dhënë. Ne kemi pas rastin e vërshimeve, i kemi marr ato fonde, i kemi qite tjetërkund, ne kemi pas rastin e dëmeve te erës, sivjet qe ju kanë paguar komunave tjera disa shpërblime, ndërsa Komuna e Vitisë nuk ka dhënë, pra a nuk është një hipokrizi, nëse nuk është atëherë ma sqaroni se si

munde te zhvillohet një bujqësi nëse nuk ka rrugë për me shkuar te arat e veta, si mundë të zhvillohet një bujqësi nëse nuk ka, nuk behet komasacioni edhe nuk behet rritja e atyre ngastrave që kanë posedim fshataret, edhe kjo ka mbete mbrapa. Që katër vjet po flasim edhe katër vjet mundojmë me be ceshtu, edhe ku po shkojmë në çfarë rrugë po shkojmë, po shkojmë në një shkatërrim të kësaj rinie, që e hup perspektiven për me jetu, pra, po shkojmë në rrugën e varfërisë të mëtutjeshme edhe normalisht i përmendem taksat, nuk kem me pas mundësi mi pagu takstë as na që kemi nga pake rrogë se le ma ata që nuk kanë rrogë fare.

z.Ali Bajrami: Përsëritje kryesuese, nënkryetar, asamblist, drejtor të drejtorive përkatëse, KFOR amerikane. Para veti korniza afatmesme buxhetore (KAB) e Komunës së Vitisë 2017-2019 që e kemi, është një dokumente i cili përgatitet nga zyrtaret e Administratës Komonale çdo vit dhe miratohet në parime çdo vit nga asambleja komunale. Fillimi i hartimi të KAB-it është me kohë, ashtu siç parashihet edhe me ligje. Të gjitha prioritetet në kornizën afatmesme buxhetore janë të parapamë, ku këtu i kemi të përfshimë, në mes të shume prioritetëve edhe pesë prioritetet me se të nevojshme për Komune të Vitisë. Në mesin e këtyre e kemi forcimin për zhvillim ekonomik, përmirësimin në shëndetësi dhe mirëqenia e qytetarëve, përmasimi i ambientit, krijimi i sigurisë për qytetarët e Komunës së Vitisë, dhe funksionalizimi i Qeverisë Komonale, që hynë në shërbim efikases të qytetarëve. Nëse e shohim tabelë faqe 11 të buxheti, sipas viteve, ku janë të parapamë, dhe e lëshojmë një shikim diagramit, vërehet se kemi një ngritje të letë buxhetore në krahasim në vitin 2016, 2017 për afërsisht kemi diku 500 mijë euro nuk mjafton, por është shpresë dhënëse se me ngritje të buxhetit do të rritet edhe mirëqenia e qytetarëve të Komunës së Vitisë. Ajo çka është këtu, se planifikimit të të hyrave të komunës nëpër të gjitha drejtoritë, planifikimet që i kemi janë planifikime dhe nuk ka asgjë strikt që po vërehet këtu, janë planifikuar me shume ja me pakë, mu po me inkurajon aty ku janë të planifikuara më shumë e ku është ajo e mirë që ato që janë të planifikuam me shume edhe ti grumbullojmë, se të gjitha këto mjete do të derdhen dhe do të shfrytëzohen nga qytetarët e komunës. Nëse hymë e i shikomi edhe të hyrat buxhetore, atëherë i kemi dy kategori nga grandet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Grandet qeveritare, shërbime dhe mallra e paga, janë diku 89%, e ku 11% i ka për investime për projekte kapitale e vetmja mundësi është që me një angazhim shtesë, që të bëjmë përpjekje maksimale për rritjen e të hyrave vetanake, se me këto rritje të hyrave vetanake do të kemi mundësi edhe të rritim investimet për projekte kapitale, se janë mjete me një mënyrë të qeveris se vete komunale. Mos me ju marr kohe me tepër, por mas asaj që tha Mirlinda, për plan, për projekte për investime kapitale, pse na mos ta kemi një tabelë, kur kemi qen nxansa, profesorët na thoshin, kush kopjon merr njisha, prandaj në nuk kemi nevojë me kopjuar, se kemi kundër të mjaftueshme për mi be vete. Ju faleminderit!

znj.Selvie Rexhepi: Unë kisha me përgëzuar drejtorin edhe stafin e tij për hartimi të kësaj kornize afatmesme, mirëpo për mu është e dhimbshme, jo vetëm sot po gjithëherë, edhe sidomos kur u planifiku buxheti për 2016-ën. Zvogëlimi i kapitaleve, mos të ishin të hyrat vetanake këtu që shtohen për 500 e 50 mijë, sigurisht të hyrat vetanake veç po shkojnë edhe po kërkojnë standarde, po bëjnë vërejtje për kapitalet, pse kjo rrugë edhe ajo rrugë, se të ishte diku tjetër një rrugë me 1 milion e 594 mijë do të ishte shtruar vetëm një rrugë me standarde dhe nuk do të kishim pas vërejtje, edhe që diskutojmë këtu që është bërë mirë a po është bërë keq, kjo është fatkeqësia e politikave që bëhen lartë me zvogëlimin e kapitalit unë kisha kërkuar nga drejtori që me të vërtet të japin edhe vërejtje këtu se kjo nuk është në rregull se çdo vit të shkohet në zvogëlim të kapitaleve ana tjetër çka kisha dashtë me pyet nga grandet qeveritar ndahen pagat bile për 2017 është mëndu që të rriten pagat vlera e tyre për 388 mijë e 449 euro, për staf prej 1141 vetave, po nga të hyrat vetanake ndahet edhe 30 mijë euro

numër te stafit këtu nuk është parapare drejtori e arsyetoj ata se gjithë her qeveria ka qen dmth jo e gatshme po ka qen ne nivel te detyre se saj qe ti plotësoj pagat këto 30 mije euro drejtor kisha pas ne dit pse çka janë parapare çka nuk po munde te plotësohen nga grandi qeveritare për këta edhe kjo ishte ajo pyetja, ka edhe diçka tjetër dmth te shpenzimet kapitale me te verete qe na e dimë qe shume projekte deri sa ato i mbesin nesër ne pronësi te komunës, sigurisht qe kerkojnë kosto financiare për tu mirëmbajt. Unë kisha kërkuar qe ato te rriten me qellim se është një vlerë shume e vogël, qe me te vërtetë ka nevojë pak me shume. Unë pikërisht këtu te pagat, këto 30 mije eurosh çka keni menduar qe ta plotësoj at kuotën.

z.Bekim Azizi: Faleminderit kryesues për fjalën! Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e Komunës së Vitisë 2017-2019, qe është leximi i parë, besoj qe është i pakënaqshëm, mendoj se secili prej neve kemi deshtë me pas një buxhet me te madhe, ndoshta do te jete një angazhim me i madhe, qe kur te na vjen ne leximin e dyte te jetë një shifër me e madhe me qet buxhet prej 10 milionave është buxhet i njëjtte i vitit te kaluar, ndryshon diku 500 mije euro, mirëpo vitin e kaluar, ne krejt e dimë qe e kemi pas mbi 400 mije euro planifikime mangët te pagat ne arsim e ne shëndetësi. Mirëpo, d.m.th e shoh ne këtë kornizë buxhetore, shërbimet dhe mallrat kemi pluse 30 mijë euro, që janë shtruar vitin e kaluar, janë shtruar 42 mije euro, d.m.th çdo herë po shtohen nga pak te shërbimet e mallrat, d.m.th qe zakonisht po tentohet te jetë ne zbritje. Për mua tashti ne shohim qe te hyrat vetanaka kanë qen mbi 900 mije euro për vitin qe shkoj, ndërsa për vitin e ardhshëm nuk i kalon 1 milion, diku rrethe 100 mije euro është diferenca, qe është obliguar, mirëpo na kemi marr këto mesa ne mënyrë shabllon, kemi shkuar, qe ndoshta nuk do te jetë një planifikim real i te hyrave vetanake, qe do te bëhen. Unë shoh prej këtyre, nuk isha ndal shume pak te inspektimi i ambientit, p.sh.: te planifikohen vetëm 400 euro janë pak, sepse sidomos këtu ka mundësi ne ambient inspektimi te jete ose te planifikohet gjoba ne komunikacion 75 mije euro, nuk e di ndoshta mos është shume e madhe. Në arsim e pashe qe nuk janë te planifikuara mire, sepse vetëm mësimi jo formal i parasheh 900 euro te hyra, edhe çerdhja 20 mije tjera te hyra, nuk parasheh, ne e dimë qe neper shkolla ka te hyra, sidomos te dokumentet duplikat, qe ne këtë kodin buxhetor nuk e parashohim e nëse nuk e parashohim nuk duhet as ta mblidhemi. Mendoj qe duhet te kompletohet ne leximet e tjera, çka nuk janë paraparë ose çka nuk i kemi përfshi këto, megjithatë te rritja e subvencioneve te kryetarit na po e dimë qe i kemi rrit për fushat, se është vit i fushatës, mendoj qe nuk është ne rregulle, ka qen dashur te shkojmë sikur tri vitet e tjera qe është kane me mirë është dashtë te rriten subvencionet ne Drejtorinë e Kulturës dhe ne Bujqësi, sepse sidomos investimet. Unë mendoj klubet sportive, futboll janë shume te domosdoshme terrenet sportive, qe te ju mundësojmë një zhvillim te kulturës, te rinisë e sportit, ne veçanti sporti, sepse po e shohim qe sporti po është numër një tash edhe ne bote. Ju faleminderit!

Drejtori z.Ibrahim Rama: Faleminderit kryesues për fjalën! Po fillojmë nga pyetjet e fundit, me pyetjen e Bekimit, parashtror disa pyetje, duke filluar nga subvencionet te kryetari, rritja e tyre. Kjo nuk është absolutë, është ne procese, mundemi me ndryshuar nga vlera e buxhetit, nga viti 2016 me vitin 2017 është vlera 142 mije euro, unë mendova si drejtor i drejtorisë 30 mije me e rrit fondin e subvencioneve, 30 mije euro është ne kategorinë ekonomike për shërbime dhe mallra, se ka nevojë, se shërbime dhe mallrat janë, se jem te gjithë te vetëdijshëm, se na duhet me pas me pastër, qytetaret duhet me qen me te kompletuar me shërbime te komunës dhe 82 mije euro mendova me qenë investime kapitale, naj projekt qe kishe me qenë interesant për qytetaret e Komunës se Vitisë, pra, këtë diferencë e kam planifikua kështu, nuk d.m.th qe duhet me ndodhe kështu, po ja qe për momentin kemi mëndu në drejtori, qe këtë shpërndarje ta bëjmë ne këtë kuptim, për ndryshe pjesa tjetër e

buxhetit është e njëjte me vitin 2016. Tashti nga shuma e përgjithshme e buxhetit të viti 2017, prej 10 milion e 19 mijë e 300 euro, 71% janë paga e 2% janë komunal, kategori ekonomike që me se paku kemi mundësi me ndikuar edhe me ndryshuar, edhe ju si asamblast, edhe ne si qeveri. Pjesa tjetër që po jete e buxhetit, prej 28%, duke filluar nga investimet kapitale, subvencionet dhe mallrat dhe shërbime, pra, krejt shuma e buxhetit 28%. Krejt maksimumi behet i aktiviteteve të qeverisë komunale dhe juve që këto mjete 28%, ti drejtojmë, ti adresojmë aty ku është me se miri. A do të ja arrimë qëllimit, unë prapë them, edhe në fund kur ta miratojmë ka me metë shumë sene, d.m.th që nuk kanë me qen të plotësuar, gjithë një duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Na nuk duhet me i marr qef vetvetes, unë së paku si financier bashke me juve, po ky buxhet është shpërnda në mënyrë të drejtë, në bazë të fondit që është në nivel të Republikës së Kosovës, i paraparë me të gjitha kriteret, i kam analizuar ka dy tri herë dhe shpendaria është saktë në baze të kriterëve që janë caktuar nga Komisioni ndërministrorë dhe që janë pjesëmarrës në atë komision edhe komunat. Pra, në atë kuptim shpërndarja është 10 milion e 19 mijë euro i shpërndarë nga ai buxhet, por një defekt që gjatë shpërndarjes së buxhetit, që unë e kam parë si ekonomist, për të gjithë ata që i përcjellin problemet financiare, që disa politika makroekonomike nuk janë nën ndikimin e komunave edhe pse në pretendojmë të jemi pjesëmarrës në ato makropolitika, por ja që nuk na lejon ligji, është fjala për shpërndarjen e buxhetit në nivel qendrorë, është formula e caktuar diku 22%, e komplet buxhetit të Republikës së Kosovës shkon neper komuna, pjesa tjetër shkon në ministritë përkatëse të nivelit qendror, dhe nuk mundim me ndryshuar atë që është miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, por që po lidhna me pyetje që e beri Selvija, në kuptimin e investimeve kapitale, në edhe unë si drejtor i Financave, po edhe të gjithë ju e çdo qytetar, d.m.th investime kapitale janë kategori ekonomike, ku me së shumti në duhet me pas, d.m.th tretman kësaj kategorie duhet mi dhënë, dinamika e rritjes së kësaj kategorie ekonomike, problemi është që në këtë strukturë të buxhetit nuk mundim me ndryshu të hyrat e përgjithshme janë këto, shpërndarja është kjo, duhet me shpërnda në paga dhe në pjesën tjetër në shërbime e mallra, investime kapitale dhe subvencione. Përndryshe investimet kapitale nga viti 2014 dhe 2015, ju të gjithë jeni të vetëdijshëm dhe unë bashkë me juve e dimë që diku nga 600 ose 700 mijë euro i kemi me të vogla nga 2 milion e 283 mijë në vitin 2014, në vitin 2015, 2 milion e 183 mijë kemi ra në 1 milion e 511 mijë, arsye e sakët që e dinë të gjithë është ajo 0.5%, e provojë se punës që ka ndiku vetëm në komune tone dikune 400,500 mijë euro për të gjithë punëtorë dhe kjo edhe në nivel të Kosovës është problem që me politika makro ekonomike ka ndiku në ramje dhe problemi tjetër i buxhetit të vogël kjo është në lidhëmeri me pyetjet që i beri Bekimi dhe disa të tjerë, buxhetin kemi dëshirë krejt mu kanë me i madhe por është ky që është dhe në rritje e buxhetit komunale janë faktor dominant edhe të hyrat vetanake dhe problemin në KPF e kanë shpjegua është intence e fondit monetar ndërkombëtare që është tu be presion në qeverinë e Republikës së Kosovës që të hyrat maksimale për vitin 2017 me qenë diku 60 milion euro dhe që është e pa mundu me kapacitetet që deri me tash që kanë ndodhe në Kosovë është e pa mundure dhe ajo që është mëndu dhe që mundet mu realizo është dikune 50 milion euro, 10 milion janë deficite në kuptimin apriori se a do të arrin qëllimin që e ka caktuarë kufirin fondi monetar ndërkombëtare dhe pikerish edhe kjo shpërndarje është menduar me të hyrat vetanake neper komuna se në vitin 2017 e kemi për 167 mijë euro me shumë me grumbull të hyra vetanake në krahasim me vitin 2016 dhe janë caktua në Ministri të Financave kriteret cila komune në baze të kriterëve mundet me mbledhë sa të hyra dhe neve na ka dalë në baze të atyre kriterëve të Ministrisë së Financave, që në Komune e Vitisë duhet me i mbledhë 1 milion e 900 mijë euro, dhe ka qenë, unë menjëherë kam reaguuar, ka qenë d.m.th shifër e pa realizueshme

definitivisht, dhe kemi ardhur ne konkludim, te gjithë përfaqësuesit e te gjithë buxheteve komunale, drejtorët, qenë me e gjete një formulë tjetër dhe e kane nda krejt para një muaj e gjysmë ka qenë, dhe ka qenë propozimi im i pari, qe e kanë miratuar te gjithë drejtorët e tjerë edhe Qeveria e Republikës se Kosovës, gjegjësisht Ministria e Financave, qe kam thënë te merret provoja mesatare e tri viteve te fundit sa kanë mbledhë komunat te hyra vetanake dhe te shtohet diku ne një 10%, qe me ja rrit një nivele, d.m.th një kërkesë me ja be, qe secila komunë me i ndjek ato rezultate, qe me pas te hyra me te mëdha dhe kështu ka ndodh edhe ne këtë vit, diku ne duhet 10%, na u kane shtu te hyrat vetanake, d.m.th për vitin 2017 dhe na duhet me bë qe këtë fond me e plotësuar nga te hyrat vetanake, se është ne te mirë te te gjithë qytetarëve. Pata pyetje, buxheti i vogël, edhe unë po them qe është i vogël, definitiv pajtohem me te gjithë ata qe thonë i vogël, por duhet mu sill na konform te asaj qe është, d.m.th reale qe ekziston ne fondin financiar te Republikës se Kosovës. Sameti tha, shërbimeve publike duhet me ju dhanë prioritet definitiv, po por prioritet duhet me i dhëne edhe ndërtimit te kanalizimit, edhe shume projekteve te tjera, p.sh.: ndërtimi i shkollave përfundon ne vitin 2016, përfundon se e vetmja shkollë qe tha dikush, keni ndarë pak për shkolla, se e vetmja shkollë qe është e pa ndërtuar, qe nuk i plotëson kriteret është shkolla e Pozharanit, edhe qe ajo është miratuar, d.m.th projekti dhe është ne fazën e implementimit, tenderi është shpallë kështu qe ne me buxhetin e vitit te ardhshëm, duhet me planifikuar vetëm mirëmbajtje e shkollave, d.m.th vetëm renovimin e shkollave, kurse për shërbime publike, unë pajtohem qe duhet vazhdimit me buxhete ta rrisim fondin e shërbimeve publike, se përmes shërbimeve publike fondin qe e ka drejtoria përkatëse, ndikon drejtpërdrejt ne performancën, kane avancu qytetarët, bukuria, pastërtia, mbeturinat, te gjitha janë këto kriteret qe edhe ne si Republikë e Kosovës jemi duke i ndjekur pranimiti ne bashkimin evropian, ku është një nder kushtet kryesore është edhe d.m.th, ambienti. gjegjësisht pastërtia e ambientit, pra, pajtohem plotësisht ne jemi duke bërë përpjekje maksimalisht ndryshimet janë evidente dhe qytetarët edhe ju i shini, nuk janë ndoshta ne atë kuptimin sa kemi dëshirë, por qe ndryshimet jemi duke i bërë se unë vazhdimisht kam plotësuar mjete për këtë dikaster, është fjala për shërbimet publike. Një pyetje tjetër nga Sameti, ke Ministria e Infrastrukturës, vlera 497 mijë euro si investim ne Komunën e Vitisë jo 497, por ne momentit qe e kemi përgatit KAB-in, kanë qenë 497 mije euro, projekte qe i financon Ministria e Infrastrukturës ne Komune e Vitisë, qe ato mjete naj ka bart neve me rishikim te buxhetit, qe na ti ekzekutojmë këto projekte, është fjala për tri projekte, asfaltime Remnik-Nasal, Ballanc-Terpeze dhe Radivojc-Devaj, te tri rruge i kam edhe shifrat sa kushtojnë, por bëjnë ne vlerën 497 mijë euro, dhe tjetrën marrëveshje qe e kemi me Ministrinë e Financave është edhe 69000 euro, ka mu financu projekte ne këtë vite është projekt dy vjeçar edhe ne vitin e ardhshëm, duke silluar nga rruga e Stubelles dhe lista e investimeve te asfaltimeve te rrugëve rurale, qe kane me ndodhe ne Komunën e Vitisë, pra, veç Ministria e Infrastrukturës mbi 1 milion euro ka me qenë, d.m.th projektet qe kane mu financu, ne bashkefinancim kuptohet, por, kryesisht 99% janë te Ministrisë se Infrastrukturës, pra, kjo shume e paraqet 497 finishin për këto tri rrugët te cekura me lartë. Pyetje tjetër ishte subvencionet, po ja qe edhe këto subvencionet qe janë edhe e drejt me ligje, subvencione ka te drejt Kryetari i Komunës, Drejtoria e Kulturës dhe Drejtoria e Bujqësisë, këto tri dikastere, d.m.th kanë ligjërisht te drejtimi me u dhanë subvencione dhe ne po mundohemi me i plotësua kërkesat e tyre, edhe pse janë shume te vogla. Ky fond për subvencione është i vogël, por ja qe te kryetari naj ka marr mendja qe duhet çekjo shumë me qenë te Drejtoria e Kulturës. Ju e dini qe kur kemi ardh na, e kam gjetur unë me 30 mijë, euro ne realitet 28 mijë ka qenë fondi për subvencione, e ne e kemi bërë 38 mijë, po planifikojmë sivjet me be diçka, naj ndryshim nëse na lejohet me qarkoren e dyte apo eventualisht me te treten. Kështu që

edhe ne nuk jemi te kënaqur me këtë strukturë te subvencioneve, por ajo qe ne bujqësi është me prekshme, pajtohem plotësisht me te gjithë ata qe e përmenden subvencionet ne bujqësi, po ja qe disa politika makro kane ndikuar dhe janë aktuale ne fuqi, qe investimet ne bujqësi, pjesën dërmuese te subvencioneve e ka niveli qendror apo një komision përkatës qe merret me subvencionet e bujqësisë Në këtë mundësi nuk kemi drejtpërdrejt te ndikojmë, por ne mënyre politike dhe ne mënyre te drejtpërdrejte ndikimin tonë e kemi shtrirë edhe ne Ministrinë e Bujqësisë, te komisioni përkatës dhe shume fermer te Komunës se Vitisë kane përfitu donacione te ndryshme, duke filluar nga serat, d.m.th ne kuptimin e zhvillimit te bujqësisë, por për momentin është ne fuqi ligji qe pjesën dërmuese te subvencioneve e ka niveli qendrore. Pat pyetje për listën e investimeve kapitale, krejt investimet kapitale praktikisht shihen edhe pajtohem, lista ka me ndodh, ne jemi ne përgatitje te listës se investimeve kapitale për vitin 2017, por për momentin mos me be shume subjektiv as drejtorin as kryetarin e as juve, por është herët me dal me listë, se dikush paragjykon, na jemi duke e përgatit një listë gjithnjë që me qenë transparente dhe me qenë e pranueshme për te gjithë për arsyeje se këtë listë nuk do ta publikojmë pa i krye te gjitha procedurat qe janë demokratike, duke filluar nga KPF-ja, Kuvendi Komunal, dëgjimet publike, me struktura te ndryshme te qytetarëve dhe ne fund kur ti analizojmë te gjitha këto do ta bëjmë një liste përfundimtare qe ne funde do te varet nga ju a do ta miratoni a po jo. Një pyetje ishte për sigurime shëndetësore, për momentin me qarkoren e parë nuk i kemi paraparë veç e kemi kufij të at kornizën e te hyrave te grandit qeveritare tu e përfshi nga grandit i përgjithshëm nga grandit i arsimit, grandit i shëndetësisë dhe qe at strukturën e brendshme, d.m.th çka ka me ndodhe me sigurimet shëndetësore nuk ka hala saktë, çka me bë ne qoftë se ajo kish me ndodhë, buxhetit tonë do ti vyeshin edhe shume mjete financiare tjera sikur vjet qe ka qen me 05% pagesa e provoje se punës, shpërndarja e te hyrave vetanake e thashë qe është një problem qe vjen nga kërkesa e fondit monetar ndërkombëtar e lëshohet deri ne kuvendet komunale ne te hyrat vetanake qe kemi me i mbledh prej 1 milion e 106 mije euro un ja kame bere me dije te gjithëve drejtorëve te dikastereve ne qeverinë komunale dhe këta janë përpjek qe këtë shpërndarje ta bëjnë ashtu si qe është me se drejti përmes inkasimit te taksave qe janë te lejuara me ligje, dhe këtë deficit edhe ne qofte se apriori e kemi dijen se nuk kemi me mujt me i mbledhë ndoshta 100% për 100%, por bilem kjo shpërndarje te jete me mënyre për afërsisht e njëjte qe mos me dal përqindja me një drejtori shume e madhe e me një drejtori shume e vogël, por qe me qenë konform një realiteti qe është ne funksion te një drejtësie minimale. Një pyetje tjetër ishte nga Selvija, 30 mije euro, pse janë paraparë ne kategorinë ekonomike nga te hyrat vetanake për paga dhe mëditje, si zakonisht sakët nuk dijet lista e pagave për veç listës se pagave ka një kategori tjetër qe është e punëve te kujdestarisë, qe janë ne Drejtorinë për Shëndetësi dhe një pjesë e kësaj strukture te këtij investimi, i te hyrave vetanake prej 30 mije euro e kape edhe pjesën tjetër te punëtorëve, qe apriori saktë nuk dijet pushimet e lehonisë dhe këtë fond e kemi menduar me intervenur aty ku ka mungese deficitit ne listën e pagave, e ku viteve të kaluar ka qenë problem nëse ka munguar fondi për paga dhe mëditje, ata edhe e kane shty pagesën, bile një rast e kemi pas në Drejtorinë e Arsimit, nuk ka pas mjete për paga e mëditje, ku e kanë e kanë shty 3 ose 4 ditë, deri janë sigurua mjetet për mu bë shpërndarja e pagave. Ky është një problem shume i madhe, unë kam konsideruar qe duhet me pas një fond rezervë me intervenuar te pagat, qe punëtoret 1100 e sa janë ne listën e pagave ta marrin pagën me kohë e ne qoftë se nuk ka me pas nevojë këto janë te hyra vetanake i shpërndajmë me rishikim apo me një metode tjetër prapë për te mirë te qytetarëve te komunës se Vitisë.

Nënkryetari z.Hasan Alia: Unë do të jem i shkurt, pasi që edhe bëra përpjekje të kompletohem me të gjitha ato të dhëna, është fol shumë për mos investim në bujqësi, prandaj është mirë të jem shumë korrekt dhe të thomë çështjet në formën dhe mënyrën siç kemi veprua si qeveri komunale, sa kemi subvencionuar dhe sa kemi bashkëfinancuar me organizatat e ndryshe. Unë do të numëroj, d.m.th vetëm makina mjelëse i kemi dhënë 68, 203 fermer i kemi të cilët ju kemi shpërnda fuli najllani, 80 fermer i kemi të cilët kanë marr krune për ushqimin e bagëtive, 55 familje i kanë marr pula vojse, 24 fermer kanë marr makina spërkatëse, mekanizëm bujqësor, të cilin e ka shpërnda, që kanë qene financues ProCredit Banka, por që e ka organizuar Drejtoria për Bujqësi. Në panairë janë 5 makina tharje, të cilët vlera e saj 16 mijë euro është shpërnda vitin e kaluar, fermerët të cilët i kanë marr janë 60, të cilët kanë marr mjedër, fidanë të mjedrës dhe të cilët i kanë miell dhe sot i kultivojnë, dhe kështu që Komuna e Vitisë, në bashkëpunim me fondacionin Kosovë Luksemburg kanë ndihmuar disa fermer me serra, mekanizëm bujqësor pajisje për blegetari, fidane të pemëve dhe pajisje për përpunimin e mishit dhe të rakisë. Jem në gjendje me javë sjell edhe kush i ka marre për me vonë, kush të do. Organizata **irintinternacional**, në bashkëpunim me Komunë e Vitisë, ka shpërnda disa serra, bimë mjekuese dhe makina mjelëse, ku kanë përfituar 11 fermerë. Të ju them një tjetër, se në rast që ju i merrni vetëm subvencionet janë pake vetëm me Kosovën e Luksemburg, me këtë fondacion Komuna e Vitisë, ka bashkë financua 67 mijë euro. Prandaj mos i shikoni vetëm subvencionet, po që 67 mijë i ki vetëm Kosovë Luksemburg që ka investuar, ku është financuese komuna e Vitisë. Prandaj, janë forma të ndryshme të cilët kemi bërë dhe po bëjmë për çdo ditë në bujqësi. E dimë që është sektor i ndiheshem, e dimë që duhet të japim prioritet, megjithatë e tha edhe drejtori, po e thamë edhe unë, me muj e kisha dhjetë fishu buxhetin e Komunës së Vitisë, dhe në kuadër të kësaj ne po bëjmë përpjekje shumë, të jem të përgjegjshëm.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë po e qes në votim: Kush është që të shkon në lexim të mëtutjeshëm kjo kornizë buxhetore, ju lutem me ngritje dore. Me 17 vota për, 1 kundërt, 5 abstenime, shkon në lexim të mëtutjeshëm korniza afatmesme buxhetore. Ju falënderoj të gjithëve që dhatë kontribut.

Pika e tretë

Propozim rregullore për plotësim dhe ndryshimin e rregullores mbi Transparencën Nr.01-013/592.

Kryesuesi z.Naim Pira: Këtë rregullore Kuvendi e ka miratuar në vitin 2014, por me qenë se është një udhëzim administrativ, i cili ka insistua që të ndryshohet në disa nene kjo rregullore, Zyra Ligjore ka punuar në këtë drejtim dhe ju ka sjell para juve, i keni edhe ndryshimet të cilët ju kemi bashkëngjitur, po sido qoftë, po ja japim fjalën përfaqësueses ligjore, Albulena Haxhiut, që në pika të shkurta të naj elaboron këtë çështje.

znjAlbulena Haxhiu: Përsëritje për të gjithë! Bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, në koordinim me dispozitat ligjore të Statusit të Komunës së Vitisë dhe veçanërisht me dispozitat ligjore të udhëzimit administrativ për transparencën nëpër komuna, Kryetari i Komunës, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisë dhe autorizimeve ligjore, e propozon një propozim të tillë. Udhëzimi i fundit administrativ nr.01/2015 për transparencën i obligon të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, që ta bëjnë një ndryshim të tillë. Komuna e Vitisë, gjegjësisht Zyra e Kryetarit, ka bërë harmonizimin e dispozitave ligjore të rregullores me udhëzimin administrativ. Nenet që kam pasuar ndryshime janë kryesisht neni 3, neni 10, ndërsa nenet që janë shtuar plotësisht, nene të reja janë neni 7, neni 9, neni 11. Prandaj, unë ju ftoj që ta miratoni këtë propozim rregullore, për faktin se nxirret në pah transparenca dhe puna e mirë që po bëhet. Nëse keni ndonjë pyetje apo ndonjë shpjegim shtesë urdhëroni.

z.Sami Demelezi: Është një rregullore e punuar mirë, edhe pse në këtë aspekt, d.m.th për transparencë jemi ndër komunitet e para në nivel vendi, andaj duke e pasur parasysh faktin se ishimi transparent dhe vazhdojmë të përkrahim transparencën.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim po e hodhi në votime: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës: Konstatohet që me votat e të gjithëve prezent u miratua edhe pikë e tretë e rendit të ditës.

Pika e katërt

Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme të Komunës Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti.

Kryesuesi z.Naim Pira: Për këtë pikë fjalën ja japim drejtorit, që të na njofton për këtë propozim vendim.

Drejtori z.Mufail Halabaku: Përshëndetje, përshëndetje për Nënkryetarin, të nderuar koleg Drejtor, Këshilltar Komunal! Para jush e kemi një propozim vendim të rëndësishëm dhe shumë të nevojshëm, sidomos për fshatin Sadovinë e Jerlive, i cili ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme të Komunës Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti. Me këtë propozim, propozohet që të jepet në shfrytëzim afatgjatë, gjegjësisht 99 vjeçar, parcelat me nr. 54/2 sipërfaqja 1231 m² parcela, nr. 441/2 me sipërfaqe 309 m² dhe parcela nr. 71/2, me sipërfaqe 460 m². Në total, të gjitha bëjnë me sipërfaqe prej 2000 m² ose 20 ari, për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Sadovinë e Jerlive. Ky është një arsye shumë e shkurtër i këtij propozim vendimi, andaj nëse kemi ndonjë pyetje ose paqartësi ju lutem urdhëroni. Ju faleminderit shumë!

z.Sejdi Emiri: Përshëndetje për të gjithë! Është një vendim i cili e përkrahim gjithsesi, mirëpo i ka disa shqetësime të banorëve të Sadovinës, sepse ata mendojnë që vendi ku është nda atje është pakë larg prej lagjeve që janë kanë në fillim dhe është shqetësim i rëndësishëm, sepse vendi ku graviton prej kahut, prej lagjeve "Miftari", se është larg, ata kanë kërkuar, e ku besoj që edhe ju jeni të njoftuar, kanë kërkuar me gjete një vend adekuat, ku të gjithë me pas një fare mesatare me diku 5-10 minuta. Unë mendoj që është mirë me e kthye prapë dhe një herë këtë propozim vendim, atje të ata banorë dhe ata le të merren veshe se nuk kemi pengesë, unë personalisht nuk jam i ati fshati e për mu kudo qoftë sa problem, mirëpo është shqetësim i tyre që e kanë përcjell. Edhe unë po e përcjelli në Kuvend, kështu që, është mirë prej kryetarit të fshati me u ulë edhe një herë me bisedua me ta dhe me arsyetua vendin ku i përshtatet gjithëve, e jo vetëm disave që janë në pushtet, edhe tash po e qojë në lagjen temë, edhe pse xhamia ka qenë atje poshtë ku është, mirëpo tash fshati është rrit, kërkesat janë rrit, edhe është e arsyeshme me bisedua edhe një herë për këtë.

z.Bekim Azizi: Faleminderit! Vetëm një sqarim të shkurtër, parcela 441/2 po shihet që është një pjesë si rrugë, a është mendu që tash të behet një zgjidhje tjetër e kësaj rrugë, që është në mes të pjesës që e ndanë, ndërsa për neve është i pranueshëm ky propozim vendim.

Nënkryetari z.Hasan Alia: Çështjen që e ngriti Sela, kam qenë në rrjedh të problemit, po bëjë përpjekje maksimale me e shtjelluar, edhe për neve ka qenë shqetësuese, se kanë qenë dy kërkesa, dhe tash në kemi qenë si pushtet të referohemi kërkesës, të cilës ka vendos këshilli i fshatit, dhe këshilli i fshatit me shumicë absolute ka vendos për vendin të cilin e kemi para jush, prandaj na jemi obligativ si mekanizëm për shkak se ai këshill i fshatit ka dal pikërisht edhe nga ish-ekzekutivi dhe Kuvendi dhe aty ka pas edhe përfaqësues të tjerë. Në anën tjetër, shumë me letë është aty ku është të ndërtohet se të ndërrohet lokacioni, i kemi pas krejt parasysh këto, edhe pse ata të cilët po e thua në largesë, është e vërtetë që është qashtu, por në rast se e shikojmë edhe pozicionet e tjera, edhe varrezat e shumë sene janë afër aty, që ndoshta në këtë formë, por kanë dal me propozime edhe ku e ka kërkuar këshilli i fshatit është me legjitim

dhe me e mirë. Anën te cilën e kanë kërkuar ata, te tjerët, disa banorë mund të shfrytëzohet edhe për çështje tjera është ne buzë te magjistrales, që mund te përdoret edhe për ndonjë parke e për sene te tjera.

z.Mufail Halabaku: Sa i parkete parcelës 441/2, qe e ceku Bekimi, është rrugë, unë po mendoj qe ekipi i gjeodetve e ka paraparë shume mirë këtë, edhe janë kanë në teren bashke me këshillin e fshatit, edhe e kanë bërë bashkimin e tri parcelave, qe e bënë qat 2000 m², ose 20 ari, e kane llogarit edhe ata se ku ka alternativa tjera për rrugë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi nuk ka te tjerë për diskutim e hodhi ne votim: Kush është qe te miratohet kjo pikë e rendit te ditës, ju lutem me ngritje dore. Konstatoj qe me votat e te gjithëve u miratua edhe pika e katërt e rendit te ditës.

Pika e pestë

Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës Kompanisë KKDFE SH.A. "KEDS" J.S.C. për vendosjen e një trafo elektrike.

Kryesuesi z.Naim Pira: Kjo behet fjalë për fshatin Skifteraj, ku është ndërtuar kompleksi i "Hoxh Januzit", është një zhvendosje prej nja 3-4 metra e trakes, dhe për me shumë, fjalën ja kaloj drejtorit.

z.Mufail Halabaku: Ky është një propozim vendim për dhënien afateshkurt, këtu behet fjalë për 15 vjet, pronën paluajtshme të Komunës Kompanisë KKDFE SH.A. "KEDS" J.S.C., për vendosjen e një trafo elektrike. Bëhet fjalë për fshatin Skifteraj, parcela ka sipërfaqe vetëm 4 m², vetëm trafa është e vendosur atje, po ju lus qe te miratohet.

Kryesuesi z.Naim Pira: E hap diskutimin për këtë rend pike: A ka dikush me diskut? Pasi qe nuk ka e hodhi ne votim: Kush është qe te miratohet kjo pikë e rendit te ditës. Konstatoj qe nga te gjithë te pranishmit u miratua edhe pika e pestë e rendit te ditës.

Pika e gjashtë

Informatë për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve në Komunën e Vitisë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ne vitin e kaluar e kemi miratuar planin e punës te Kuvendit Komunal te Vitisë, d.m.th, ne Shtator te vitit te kaluar dhe ne planin e punës është paraparë që te kemi edhe informata ne lidhje me mirëmbajtjen e rrugëve edhe dimërore edhe verore. Në aspektin për mirëmbajtjen e rrugëve dimërore na ka informuar njëherë drejtori dhe kishte qenë mirë shurtimisht qe te na informon, tash ne lidhje me mirëmbajtjen e rrugëve verore, shenjëzimi, hekjen e barrenishtave etj.

z.Nexhmedin Jakupi: Përshëndetje për ju te pranishmit! Edhe nga informata siç e shini kuptohet, se Komuna e Vitisë ka te lidhur një kontratë për shërbimet, të cilat i bënë rreth mirëmbajtjes verore dhe dimërore te rrugëve ne tërë territorin e Komunës se Vitisë. Kjo kontratë është lidhur me 08.02.2016, është kontrate njëvjeçare, d.m.th do te vlen deri me 08.02.2017. Vlora e kontratës dikund është 48 mije euro. Ne gjate sezonës se dimrit, Drejtoria jonë, nëpërmes kësaj kompanie, ka bere largimin e bores dhe akullit nga rrugët lokale dhe hedhjen e kripës. Gjate pranverës ka zhvilluar mjaft aktivitete tjera, dhe tani jemi duke zhvilluare aktivitete rreth mirëmbajtjeve te rrugëve, duke i trajtuar te gjitha rrugët ne tërë territorin e komunës tonë, edhe nga informata qe e keni, ju i shini disa aktivitete qe janë zhvillu. Qe mos te ju marr kohë, nuk po i përmendi te gjitha, por vlen te përmendet qe komuna ka te përzgjedhur edhe kompaninë e cila merret me sinjalizimin vertikal dhe horizontal te rrugëve të njëjta. Kompani ka pasur kontratën deri ne funde te këtij muaji, ndërsa tash janë procedurat ne Zyrën e Prokurimit, qe te përzgjidhet kompania e re. Është bërë sinjalizimi edhe vertikal edhe horizontal, shenjat e lajmërimit i kemi vendos, shenja

urdhrit te pemës etj. Në pika te shkurta këto janë aktivitetet rreth informatës, për me shumë e keni te cekura ne informatë qe e keni para vetes.

z.Sejdi Emiri: E kemi thënë më herët, edhe po e përsëris. Buxheti qe është bere për mirëmbajtje e rrugëve, është i pamundur me i mirëmbajt. I dimë te gjithë, sidomos sezoni dimëror, kemi thanë qe ka pas fshatra qe nuk ka shkuar fare bageri, kemi përmend Ramjani, Navosellen, e ne disa fshatra, p.sh.: ne fshatin ku jam unë ka shkuar vetëm deri ne gjysmë te rrugës, neper institucione, as ne shkolla, as ne ambullanta nuk ka shkuar fare hiq, prandaj prapë po e them, nëse doni me krye punën qyshe duhet me krye ndani buxhet, pake është ai buxhet për mirëmbajtjen e rrugëve dimrit e verës, është e pamundur, edhe me pas vullnet është e pamundshme me arrit me at buxhet. Unë po thamë qe kompania nuk ka qenë ne nivelin e duhur, sidomos sezonin dimëror, po flas me fakte e argumente, fare nuk ka shkuar. Fatmirësisht është fat që nuk ka pasur një fare dimri qe ka sjelle borë shume, po te kishte pas borë shume, qyshe bien nga njëherë pa ndërpre, kishte me qen problem për mirëmbajtjen e rrugëve.

z.Bekim Azizi: Është zakonisht për drejtorin, po kemi me shpesh qasje, sepse janë probleme që çdoherë e prekin qytetarin edhe ndoshta këtu kurrë nuk behet bollë, mirëpo vetëm një problem këtu, që në fund kur e ceke kemi paraparë kositjen e barit rreth rrugëve. Unë e kam përcjell rreth rrugës për Pozharan, rruga Viti-Pozharan. Ne e dimë çka është kositja e barit, me hekë barin ne këtë rrugë, nuk u hekë bari aty, nuk e di a paguhet qaj shërbimi aty, kishe shku me një gërryese, ku e kishe kap atë dhevin e kishe mbuluar kanal, që është për skejt rrugës, pjesën tjetër nuk hetohet qe ka ra, d.m.th kjo nuk mundet me qen e kositmë. Drejtor bilem kontrolloni qeto, bilem qeto qe te kryhet le te kryhen. Unë e di qe nuk ka mjete ndoshta me i mirëmbajt te gjitha, ama qato qe te kryhen le te kryen mirë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi qe te tjerë nuk ka për diskutim, ju falënderojë për kontributin qe dhënë rreth kësaj pike dhe natyrisht si pike te fundit te rendit te ditës kemi.

Pika e Shtatë

Informatë për Manifestimin "Flakadani i Karadakut", edicioni XV

Kryesuesi z.Naim Pira: Konsideroj qe materialin e keni pranuar me kohe, një material i përgatitur jashtëzakonisht mirë, ku ne mënyre shume reale e objektive janë pasqyruar te gjitha shpenzimet, forma e organizimit, për me shume fjalën ja kaloj drejtoreshës.

znj.Kaltrina Sylejmani: Përshëndetje Nënkryetar, kolege Drejtorë, Asamblist! Sot e kemi përpara informatën rreth Manifestimin "Flakadani i Karadakut", edicioni XV. Unë para jush do te dal ballë hapure, duke ju referuar fillimit dhe mbylljes te një edicioni shume te suksesshëm te këtij manifestimi, ose them me mirë me një dosë te lartë te inovacioneve dhe kreativitetit. Në faqe 3 e shihni përmbajtjen, se çka ka kjo informate. Jam munduar qe ne mënyre sa me detajuar me i plasu informacionin, dhe kjo informatë pason ne detaje rrjedhën e manifestimit. Përmes kësaj informate financiare, nuk dua ta kaloj, d.m.th ta mbylle këtë dhënie te informatës, pa e falënderuar Kuvendit Komunal, për mbështetje ne pjesëmarrje te aktiviteteve tona. Drejtoria e Financave, Drejtorin e Shërbimeve Publike, dhe po ashtu akter tjerë te involvuar ne mbarëvajtjen e këtij organizimi. Në faqen tjetër e shihni, d.m.th përbërjen e këshillit organizativ, njerëzit te cilët me kane ndihmuar ne këtë manifestim, behet fjalë për katër javë pune paraprake. Para fillimit te manifestimit, unë si koordinator e këtij këshilli organizativ, kam formuar gjashte këshilla dhe secili kryesues i këshillit ka pas nënkeshillin e tij, apo thënë me mirë bartësit e aktivitetit. Mendoj qe secili bartës i aktivitetit ka qenë profesionist ne fushën e vetë përkatëse dhe ka bërë një punë te jashtëzakonshme, duke mos harruar pa than qe edhe një pune vullnetare. Ne si Drejtori e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e me pushtetin komunal, ne krye me kryetarin z.Sokol Haliti, kemi krijuar një trendë, do te thotë

përfshirjen e shoqërisë civile dhe shoqatave të ndryshme kulturore artistike, klubeve sportive qytetarëve, d.m.th futjen në vendimmarrje, dhe mendoj që kjo përbërje e këshillit ma vërteton këtë që po e them. Në faqe 6 fillon raporti i aktiviteteve, edhe në këtë viti ky manifestim ka filluar me 21.03.2016, dhe ka përfunduar me 26.03.2016, duke e vënë në pah profesionalizmi e të gjithë akterëve të përfshirë në këtë manifestim, dhe duke bërë prurje të reja e duke afirmuar vlerat kulturore. Duhet ta përmendi, se është me rëndësi që në skenën tonë të këtij aktiviteti kanë marrë pjesë 570 artist të arteve skenike, vizave dhe të fjalës, d.m.th të përfshirë direkt në aktivitete. Po ashtu kanë marr pjesë edhe 214 sportist, që si Komunë e Vitisë, mendoj që të gjithë duhet të ndihemi krenar, që përmes këtij manifestimi në shndërrimi në qendër shpirtërore të Shqipërisë. Mendoje që ky manifestim ka karakter mbarë kombëtar. Për mos me ju marr kohe me shume, informatën e keni pranuar me kohe, për pyetje e sqarime jam e gatshëm.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hape diskutim në rrethë kësaj pike të rendit të ditës.

z.Bislim Bislimi: Përshëndetje! Dëshiroj që të falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar, që ky festival të jetë aq i madhërisëm për një komunë, që është me shume probleme financiare, buxhetore. Me u bë një festival i tillë është për tu lakmuar, kjo është bere me vullnetin e madhe që ka pas kjo popullatë, kjo popullsi, këta të ri, këta njerëz që kanë fillu dhe që e kanë mëndu këtë festivale, që e kanë rrit vlerën e kësaj lufte, që e kemi bere për çlirimin e trojeve shqiptare e që fatkeqësisht politikanet tone edhe luftëtarët po i harrojnë që na kanë mete ende. Ky festival po i bashkon të gjitha trojet, të gjithë shqiptarët ku do që janë, me at idealin e pare, që kanë bere kur është krise pushka e Adem Jasharit dhe po na bane të jemi shume krenar, që po mund ti japim një shpërbleme me këtë festivale, një shpërblim shpirtëror atyre njerëzve që kanë dhënë kontribut për këtë vend, edhe që do të japin vazhdimisht. Ky flakadan e ka simbolin e vet, pra, bashkimin e trojeve që na kanë mbete prapë dhe kjo le të vazhdon deri sa ato troje të behet me një vende. I falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë në këtë festival, gjithashtu edhe asambleve edhe grupeve folklorike që vine nga shtetet e tjera, nga trojet e tjera etnike edhe madhërojnë këtë festival.

z.Samet idrizi: E falënderoj drejtoreshën për informatën shume të saktë. Unë e kam vetëm një kërkesë, gjate bërjes së këshillit organizativ të kijet parasyshe që po përsëriten ftyra të njëjta vazhdimisht, edhe unë pashe këtu me duket tre familjare që nuk është në rregull në një manifestim të tillë të caktohen aty, se pastaj mujn aty me bë komoditet edhe mu sill pak jo taman qyshe duhet. Kështu që është sugjerim, që drejtoresha të ardhmen caktojë njerëz profesionist, por jo të beje aty nepotizëm në këshilla të tillë që janë shume me rëndësi. Në e dimë që manifestimi ka qen shume i mirë, i ka dhënë jehon të mirë Vitisë mbarë kombëtare.

z.Bekim Azizi: Unë për manifestim e di që ka qenë një manifestim i mirë, e kemi përcjellë, mirëpo vetëm tek ajo që thuhet, që manifestimi me lirë nuk ka kushtuar kurrë, d.m.th nëse 14 mijë e 600 euro siç janë shpenzime nga buxheti i komunës i shtohen edhe 2800, që i ka shpenzuar Ministria e Kulturës edhe 5000 nga Zyra e Kryeministrit, del 22 mijë e 600 euro. Unë nuk mendoj që asnjëherë që ka kushtuar 22 mijë e 600 euro, kurrë me shtrenjte nuk ka kushtuar.

Drejtoresha znj.Kaltrina Sylejmani: Faleminderit Bekim për interesimin. Dua ta qartësoj, se unë thashë nuk i ka kushtuar asnjëherë me lirë Komunës së Vitisë. Pra, 22 mijë e 602 është totali i kostos së manifestimit, mirëpo në këtë rast në këtë vit, meqë që kemi pasur mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Zyrës së Kryeministrit, në d.m.th nuk është që e kemi rrite vlerën e manifestimit, por që pjesën tjetër, pra, 8000 euro e kemi bë me donatorë, partner zhvillimore në këtë rast, ose mbështetës tanë, ndërsa unë e pata fjalën që nuk i ka kushtuar as një herë me lire Komunës së Vitisë, buxhetit të Komunës së Vitisë, d.m.th se këtë

vit e kemi pas 14 mije e 602 euro, çka mendoj qe perime nuk ka qenë asnjëherë me lire dhe ne rast qe ju dyshoni mundet ti hapni raportet e mëhershme.

z.Visar Demiri: Vetëm një përmirësim deshta. Në kohën e qeverisjes së PDK-së "Flakadaku i Karadakut" kurrë nuk ka merri 14 mije euro, me të njëjtat aktivitete që janë bërë, tash i keni të gjitha këtu, kanë ardhur ansamblet edhe shtetëror i Tiranës, edhe i Kosovës dhe të gjitha ansamblet e tjera, por nuk ka merri 14 mije asnjëherë.

Drejtoresha znj.Kaltrina Sylejmani: Unë dua ta falënderoj paraardhësin time, që është munduar dhe ka punuar për këtë manifestim, z.Visar Demiri, dhe unë kam parë dhe është e vërtetë që ka kushtuar me shtrenjte, d.m.th drekat kanë qenë jashtëzakonisht të një çmimi shumë të lartë dhe ju e dini që ka kushtuar me shtrenjte, ndërsa se a kanë qenë aktivitetet e njëjta, e dimë që nuk kanë qenë aspak dhe ato aktivitete që janë organizuar janë organizuar në një nivel mendoj jo të kënaqshëm. Përpos kësaj, që tri vite kanë ardhur prurje të reja, aktivitete të reja dhe ansamble të reja. Nuk është se duhet të krahasohemi, meqë konsideroj se që tri vite Flakadani është shumë më i suksesshëm se çdo vit më parë. Ju faleminderit!

z.Visar Demiri: Është përmend shumë herë, që edhe në vitin e kaluar e kam dëgjuar edhe prej nënkryetarit, edhe prej drejtorisë, se ky flakadan ka qenë më i lirë e aktivitete më shumë. Unë mujt me ju garantuar, se kurrë nuk e ka merri 14 mije euro, pavarësisht pa hy në detale, se sa kanë kushtuar drekat apo organizimet e tjera më shumë, dhe çdo aktivitet që është mjaft vjetër ose sivjet, është mbajtur edhe vitet e kaluara, se është bërë format i njëjtë, standard. Kemi pas boksë vitet e kaluara, kemi pas ekspozita, kemi pas, dijet festivali i ansambleve, voliboll, futboll, pingpong e shumë aktivitete të tjera, dhe të gjitha kanë qenë edhe gjatë qeverisjes së PDK-së. D.m.th nuk ka naj risi, përveç tryezës së rrumbullakët, e cila nuk është organizuar me herët, mirëpo është nxjerr revista e festivalit në kohën tonë, e që në këtë vit nuk e kam parë që është bërë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Po ju njoftoj edhe një herë veç, që kemi një aktivitet të organizuar nga Drejtoria e Kulturës, së bashku me KFOR-in, me datë 03 Korrik.2016, ecjen në këmbë. Ju kisha lutë që si këshilltar komunal të marrim pjesë në këtë aktivitet, ata të cilët natyrisht kanë mundësi.

Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në seancat e radhës.

Mirë u pafshim!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12 e 25 min.

Procesmbajtës:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë:
z.Naim Pira